

MARREVESHJE E BASHKEPUNIMIT KERKIMOR-SHKENCOR NDERMJET AKADEMISE SE SHKENCAVE DHE TE ARTEVE TE KOSOVES DHE AKADEMISE SE SHKENCAVE TE SHQIPERISE

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (të emëruara më poshtë “të dy palët), me qëllim që të ripërtërihet dhe të zhvillohet bashkëpunimi kërkimor-shkencor midis tyre, u morën vesh për sa vijon:

Neni 1

Të dy palët do të zhvillojnë një bashkëpunim të gjithanshëm shkencor në fushat e ndryshme kërkimore-shkencore me interes të përbashkët.

Neni 2

Të dy palët do t'i japin njëra-tjetrës lehtësitë e mundshme për zhvillimin e kërkimeve shkencore me interes për secilën palë.

Neni 3

Secila palë do të ftojë studiues në veprimtari shkencore të rëndësishme që organizon dhe që paraqesin interes për palën tjetër (konferenca, sesione, promovim botimesh, etj.).

Neni 4

Secila palë do të ftojë studiues të palës tjetër për mbajtjen e referimeve, ligjëratave shkencore.

Neni 5

Të dy palët do të botojnë në organet e tyre shkencore studime të palës tjetër që pasqyrojnë arritjet përkatëse në fusha të ndryshme të shkencës.

Neni 6

Të dy palët do të shkëmbejnë literaturë dhe informacion shkencor me interes për secilën palë, do të ndihmojnë në huazimin nga fondet bibliotekare e nga materialet e ndryshme të kësaj natyre. Të dy palët marrin përsipër t'i dërgojnë rregullisht njëra tjetrës revistat dhe botimet e tyre të tjera shkencore në tri kopje.

Neni 7

Të dy palët do të shkëmbejnë kopje të mikrofilmuara ose të fotokopjuara të botimeve të rralla dhe të dorëshkrimeve me interes shkencor.

Neni 8

Të dy palët marrin përsipër të ndihmojnë për zhvillimin e bashkëpunimit edhe me institucione të tjera që nuk janë në përbërjen e tyre.

Neni 9

Shpenzimet e udhëtimit (vajtje-kthim) të studiuesve, që dërgohen në bazë të kësaj marrëveshjeje, përballohen nga pala dërguese, kurse pala pritëse siguron fjetjen, ushqimin, mjekimin dhe shpenzimet e transportit të brendshëm. Shpenzimet e vogla personale i përballon pala dërguese.

Neni 10

Mbi bazën e kësaj marrëveshjeje të dy palët do të hartojnë protokolle zbatimi, të cilat miratohen e nënshkruhen nga përfaqësuesit e tyre në takimet që do të bëhen çdo dy vjet në Prishtinë ose në Tiranë.

Neni 11

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj marrëveshjeje që do të quhen të nevojshme, do të bëhen mbi bazën e pëlqimit të të dy palëve, të cilat për këtë nënshkruajnë aktet përkatëse.


Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.
Marrëveshja hartohet në dy kopje, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë.

Nënshkruar në Tiranë, më 08 shtator 2000

**PER AKADEMINE E SHKENCAVE
TE SHQIPERISE**

K R Y E T A R I

PROF.YLLI POPA



**PER AKADEMINE E SHKENCAVE
DHE TE ARTEVE TE KOSOVES**

K R Y E T A R I

PROF.DR.NEXHAT DACI

